

AVOKATI I POPULLIT

5 ankesa

për torturë dhe trajtim çnjerezor kundër pjesëtarëve të policisë, 1 ankesë secila për SP Manastir, SP Prilep dhe SP Qendër dhe 2 ankesa për SP Kumanovë.

10 ankesa

për torturë dhe trajtim çnjerezor kundër pjesëtarëve të policisë së burgjeve, 4 për ShNK Burgu Idrizovë, 3 për INK Burgu Prilep, 2 për ShNK Kumanovë dhe 1 për INK Burgu Manastir.

Në 5 raste, janë konstatuar elemente për ekzistencën e veprës penale

5 penale

për veprën penale "Ngacim në kryerjen e shërbimit" sipas nenit 142 të Kodit Penal në Prokurorinë Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, nga të cilat 5 i referohen punonjësve të policisë.

DREJTORIA PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE

0 ankesa

për torturë dhe trajtim çnjerezor kundër pjesëtarëve të policisë së burgjeve.

PROKURORIA PUBLIKE THEMELORE PËR NDJEKJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT - DEPARTAMENTI PËR HETIMIN DHE NDJEKJEN E VEPRAVE PENALE TË KRYERA NGA PERSONA ME KOMPETENCA POLICORE DHE PJESËTARË TË POLICISË SË BURGJEVE

Janë akuzuar 21 policë për veprën penale "Maltretim dhe trajtim ose dënim tjetër mizor, çnjerezor ose poshtërues" sipas nenit 142 të Kodit Penal.

Tre çështjet kundër anëtarëve të policisë së burgjeve, për të cilat Prokuroria Themelore Publike paraprakisht kishte njoftuar se janë në shqyrtim e sipër, tani janë përfunduar.



Për 1 rast, u mor një vendim për të refuzuar akuzën penale



Për 1 rast u miratua një zgjidhje



Për 1 rast është ngritur aktakuzë pranë gjykatës kompetente

Për 16 persona janë marrë vendime për refuzimin e kallëzimit penal

Për 1 person është paraqitur kërkesa për mbledhjen e njoftimit të nevojshëm në një institucion kompetent

Kurse për 4 persona nuk është ndërmarrë asnjë veprim

\* Për veprat e tjera penale, Prokuroria nuk ka dhënë të dhëna për numrin e përgjithshëm të rasteve të ngritura në periudhën tetor 2020 - gusht 2021.

\* Për statusin e 39 rasteve/lëndëve kundër 80 pjesëtarëve të policisë që ishin në shqyrtim e sipër, prokuroria nuk ka dhënë asnjë të dhënë.

GJYKATA PENALE THEMELORE SHKUP - DEPARTAMENTI PËR KRIMIN E ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIN - DEPARTAMENTI I SPECIALIZUAR PËR VEPRAT PENALE TË KRYERA NGA PERSONA ME KOMPETENCA POLICORE DHE PJESËTARË TË POLICISË SË BURGJEVE

Për 15 rastet për të cilat procedurat ishin në vazhdim e sipër, gjykata informoi se 6 kishin përfunduar.

Në Gjykatë ishin regjistruar 13 raste të reja në periudhën tetor 2020 - gusht 2021 për veprën penale "Ngacim gjatë kryerjes së shërbimit".



Për 4 prej tyre ishin sjellë aktgjykime me të cilat ishte shqiptuar një masë alternative e dënimit me kusht

për 1 ishte shqiptuar dënimi me burg

për 1 rast ishte liruar nga aktakuza, respektivisht ishte shpallur i pafajshëm



Për 7 raste procedura është në vazhdim e sipër për 4 raste është marrë aktgjykim për caktimin e masës alternative të dënimit me kusht

për 1 rast është shqiptuar dënimi me burg për 1 rast është marrë aktgjykim me të cilin i pandehuri është liruar nga aktakuza